



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**th ë r r e t**

mbledhjen e nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **07.11.2019** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2. Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Prishtinës;
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM3);
4. Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon";
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit;
6. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019-2020;
7. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal te aksioneve në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë luftës së dytë botërore;
9. Propozimvendimi për autorizim të borxhit;
10. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01-463/02-239184/19, të datës 30.09.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman ) Ramadanit;
11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së komandantit legjendar "Adem Jashari";

12. Pyetje dhe përgjigje;

13. Të ndryshme.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01-060/01-264687/19, më 29.10.2019**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Agim Kulëta**



Faqe 2 nga 2